



# SBASHK

## Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kultures

# Arsimimi

### KULTURA E NJERIUT



*Ë-buletin*

**Dhjetor, 2018**

## Edhe një dëshmi e unitetit të fortë sindikal në SBASHK



### Në grevën njëorëshe të se enjtes 99 % e institucioneve arsimore

Për të përcjellë rrjedhën e grevën janë formuar Këshillat greviste nëpër shkolla e njësi akademike, Këshillat Greviste në nivel Komunash e të Universitetit dhe Këshilli Qendror Grevist. Ata kanë përcjellë me kujdes rrjedhën e grevës . Raportet tregojnë se greva njëorëshe është mbajtur në

99 % të institucioneve arsimore duke filluar nga çerdhet , shkollat dhe njësitë akademike, gjegjësisht Universitetet ...(faqe 10)

### SBASHK takim me Ministrin Shyqiri Bytyqi



Në përpjekje të përbashkëta për përmirësimin e Ligjit të pagave ...(faqe 6)



### Intervistë me mësimdhënësin dhe veprimtarin sindikal Murat Bytyçi

Murati është profesor në Gjimnazin "Jeta e re" të Suharekës. ...(faqe 3-5)

### SBASHK dha alarmin e fundit para grevës së përgjithshme



### Grevë njëorëshe në të gjitha institucionet e arsimit

Duke parë se janë përshpejtuar procedurat me qëllim që Projektligji i pagave,..(faqe 9)

### Në një ceremoni festive në Viti



SBASHK-u pajisi me certifikata vijuesit e trajnimeve

Pasi ishte kryer me sukses trajnimi "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social " ... (faqe 8)



## Editorial

### Një vit plot sfida



Fundi i çdo viti sikur obligon për një shpalesje të kujtesës dhe një rrugëtim mendimesh nëpër muaj. Ky rrugëtim sikur të rikthen pamje nga aktivitetet dhe të rikthen edhe sfidat me të cilat jemi përballur.

Viti 2018 për SBASHK-un shënon 12 muaj të angazhimeve të vazhdueshme në shërbim të anëtarësisë, por edhe të sfidave që nuk ishin të pakta. Në këtë vit çdo ditë sillte në detyrë të re, një ankesë a kërkesë për mbështetje sindikale. U zhvilluan dhjetëra takime me përgjegjës të institucioneve në përpjekje për realizimin e kresave që lidheshin lidhur me Projektligjin për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta . Ishin të shumta angazhimet në tejkalimin e barrierave që i krijoheshin padrejtësisht këtij projektligji dhe më në fund të gjitha procedurat e kërkuara parlamentare janë kryer dhe

SBASHK-u beson shumë se Projektligji do të votohet nga deputetët shqiptar, të cilët kështu do të shprehin respektin për sakrificat e mësimdhënësve që gjatë tërë viteve të okupimit mbrojtën arsimin shqip.

Një angazhim i vazhdueshëm nëpër muaj ishte edhe në përpjekjet për të tërhequr e korrigjuar Projektligjin e pagave, i cili në versionin aktual është degradues për arsim. SBASHK-u edhe përmes takimeve me Kryeministrin e me Ministrat kërkoi përmes dialogut që Projektligji i pagave të përmirësohet në mënyrë që të punësuarit në tërë sektorin e arsimit të kenë vend meritore në këtë Ligj. Në përballje me këtë sfidë ishte edhe protesta e 8 shtatorit dhe greva njëorëshe e 27 dhjetorit , të cilës i janë përgjigjur mbi 99% të gjithë institucioneve që nga çerdhet, shkollat e Kosovës dhe Universitetet.

SBASHK-u pret që institucionet reflektojnë pas këtij alarmi në të kundërtën të gjitha institucionet arsimore të Kosovës do të jenë në grevë të përgjithshme më 14 janar 2019.

Për çdo pyetje, sugjerim apo informata shtesë , mund të vizitoni ueb-faqen tonë:

[www.sbashk-rks.org](http://www.sbashk-rks.org)

Mos hezitoni të na jepni sygjerrime për përfshirjen edhe të ndonji rubrike në interes të anëtarësisë në gazeten e juaj elektronike Arsimi sot.

Që SBASHK-u të jetë gjithnjë në shërbim të anëtarësisë, së shpejti do të ofroj shërbime këshillimi për ngritje profesionale për anëtarët e vet si dhe së shpejti do të paraqiten video-spote në ueb-faqen e SBASHK-ut rreth shërbimeve për anëtarësinë.

**Botues: Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës(SBASHK)**  
përfaqëson rreth 20.500 anëtarë në gjithë sektorët e arsimit në Kosovë, duke përfshirë edhe komunitetet. SBASHK është anëtare e **Edukimit Internacional (EI)** që nga viti 1996.

Email: [info@sbashk-rks.org](mailto:info@sbashk-rks.org)

Tel. +381(0)38/ 226 940



## Intervista

### Intervista me Murat Bytyqi, kryetar i SAF e SAM në Suharekë



Kemi shënuar arritje të shumta në shërbim të anëtarësisë.

*Murati është profesor në Gjimnazin “Jeta e re” të Suharekës. Është veprimtar sindikal që nga themelimi i SBASHK-ut. Tani është kryetar i Kuvendit të SAF e*

*SAM në Suharekë. Ai në këtë intervistë flet edhe për arritje të shumta që sindikata jonë në Suharekë ka shënuar në shërbim të anëtarësisë. “SBASHK në aktivitetin e deritashëm ka bërë bukur shumë për forcimin e pozitës materiale të anëtarësisë së saj. Por a duhet të jemi të kënaqur dhe a ka ende për të bërë? Natyrisht se po”, shprehet Murati.*

Arsimimi sot:

#### **Kush është Murat Bytyqi?**

#### **Murati:**

Te flas në vetën e parë e kam te vështirë dhe nuk ndjem mirë megjithatë do të përpiqem te jap disa informacione të përgjithshme mbi jetën time në periudhën e angazhimit tim profesional.

Jam profesor i lëndës së Sociologjisë në Gjimnazin “Jeta e re” në Suharekë që nga viti 1979. Kam qenë anëtar në Kuvendin themelues të sindikatës sonë në nivel Republike që nga koha e themelimit të saj viteve të 90-ta ndërkaq në nivel dege kryetar deri në vitin 2004. Anëtar dhe njëri ndër themeluesit edhe të organizatës së re sindikale të SBASHK-ut nga viti 2006. Në vitin 2016 jam zgjedh kryetar i Degës së SBASHK për Suharekë e që vazhdoi të jem edhe tani.

Arsimimi sot:

**Mësuesi sot përballet me shumë sfida nga më të ndryshmet.**

#### **Murati:**

Unë kam ligjruar lëndët e sociologjisë për më shumë se 40 vjet dhe kam hasur në sfida të ndryshme.

Mësuesi përballet me fëmijë, nxënës me aftësi të ndryshme të të nxënësve. Të qëndruarit në podium të klasës është sfidë dhe përgjegjësi e lartë, sepse mësuesit i duhet që në fillim të krijojë ritëm pune dhe ekuilibër ndërmjet vetvetes dhe para 30 nxënësve me karaktere dhe inteligjenca të ndryshme. Prandaj komunikimi nga mësuesi është ai që vë bazë të mirë të komunikimit të lirë në kohën bashkëkohore me kurrikula arsimore e vënë në sfidë mësuesit të përgatitur me metodologji tjera mësimore.

Mësuesi që të jetë i lumtur me punën e tij duhet të jetë i vetëdijshëm se prezenca e tij para nxënësve nuk është sepse do të paguhet, por sepse ai është aty që të ofrojë njohuritë e arritura gjatë ngritjes akademike të tij e në dobi të nxënësve ashtu që të ngritin nivelin e të nxënësve dhe të mësuarit.

Në shekullin e zhvillimit të hovshëm të teknologjisë mësuesi duhet të përgatitet mirë dhe duhet të jeni mjeshtër i lëndës së tij ashtu që gjatë procesit të mësimit të aplikojë pajisjet teknologjike informative në mënyrë adekuate, ashtu që mesazhi i qëllimit të njësive mësimore të bartet sa më suksesshëm. Mësuesi duhet të jetë i hapur dhe i gatshëm të pranojë pyetje të cilat jo çdoherë edhe janë të artikuluar si duhet për çka edhe nevojitet ndihma e tij. Sot nxënësit pajisen me informacione nga burime nga më të ndryshmet prandaj edhe pyetjet e tyre nganjëherë edhe na mahnitin dhe surprizojnë dhe për të cilat mund të mos kemi përgjigje adekuate, prandaj të ofruarit e përgjigjes në ditën tjetër nuk është dobësi por është sinqeritet të cilin nxënësit dinë ta vlerësojnë. Pra nxënësit duhet ti inkurajojmë që të bëjnë pyetje sepse përmes tyre te ata zhvillojmë të menduarit.

Mësuesi, pavarësisht se e bënë maksimumin nganjëherë nuk mund të përçojë mesazhin e duhur te nxënësit prandaj ai duhet si një hulumtues të analizojë rezultatin dhe të reflektojë dhe ndryshojë metodologjinë apo mënyrën e të shpjeguarit.

Mësuesi sot duhet të jetë i gatshëm dhe të zotërojë mosinteresimin e disa nxënësve për subjektin e lëndës së tij por ai duhet të jetë insistues në përpjekjet e tij

sepse kjo është vetë misioni i mësuesit, në shfaqjen e mjeshtërisë për të zotëruar edhe me nxënës të pa interesuar për mësim! Mësimdhënësi pavarësisht përgatitjes së tij profesionale në kohën më të re i duhet të menaxhojë mirë me nxënësit duke gjet metoda që të zgjojë motivimin e nxënësve për të mësuar.

Këto kanë janë sfidat që mësuesi sot duhet t'i menaxhojë suksesshëm para se të del para nxënësve.

Mësimdhënia është më e vështirë sesa mësim-nxënësia!

## **Arsimimi sot:**

### **Çka do të veçonit nga të arriturat në Komunën e Suharekës?**

#### **Murati:**

Të flasësh për Suharekën dhe të mos flasësh për arsimin është e pamundur. Arsimi në Komunën e Suharekës është i organizuar në 29 Shkolla Filllore të Mesme të Ulëta dhe në 3 Shkolla të Mesme të Larta me mase 800 mësimdhënës me kuadër arsimor kryesisht të kualifikuar.

Si mësimdhënës në Gjimnazin “Jeta e re” do të fokusohem me punën dhe të arriturat në fushën e arsimit nga ky institucion arsimor e edukativ. Në këtë shkollë ndjekin mësimet 1320 nxënës që vijnë nga të gjitha shkollat urbane dhe rurale të komunës sonë. Nxënësit e shkollës sonë tash e disa vite me radhë dalin me rezultate të dalluara në nivel Republike. Ndërkaq si e dhënë tjetër domethënëse për sukseset e nxënësve tanë është se arrijnë të regjistrohen suksesshëm në shumë profile të kërkuara në Universitet. Pra, në gjimnazin tonë procesi mësimdhënies e mësimnxënies është në nivel të kënaqur si rezultat i angazhimit të personelit arsimor e i menaxhmentit të shkollës. Ne në gjimnazin “Jeta e re” e dimë secili se cili është misioni ynë i pranishëm në shkollë para nxënësve tanë. Por gjithashtu është për t'u vlerësuar edhe nxënësit tanë që janë shumë të mirë.

## **Arsimimi sot:**

### **Çka do të veçonit nga aktivitetet dhe arritjet e SBASHKU-ut?**

#### **Murati:**

Riorganizimi i aktivitetit sindikal i SBASHK-ut në komunën tonë është bërë në vitin 2007 pas një periudhë pushimi. Tani më i kemi të themeluar organizatat sindikale në të gjitha shkollat me

anëtarësim prej mbi 90% të punëtorëve. Gjatë tërës kësaj kohe nuk mungonin sukseset e Degës së SBASHK-ut gjatë këtyre viteve asnjëherë. Organizata Sindikale detyrë primare të saj ka përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesit të punëtorit të arsimit. Shembull personal të dhënies së një kontributi të pamohueshëm në mbrojtje të interesit të punëtorëve të arsimit gjatë periudhës së udhëheqjes së Degës së SBASHK-ut në Suharekë e ka dhënë kryetari ynë i nderit, tani më në pension mësuesi Sadik Shala i cili edhe më tej punon fuqishëm me kolegët e tij mësues edhe pas pensionimit.

Si sukses do të veçoja edhe organizimin e trajnimit për përgatitjen e mësimdhënësve tanë për tu pajisur me njohuri për aftësimin në përdorimin e pajisjes kompjuterike, por edhe angazhimet që si organizatë sindikale bëjmë në përgatitjen e personelit arsimor me trajnime adekuate për mësimdhënie cilësore.

Dega e SBASHK-u në Suharekë ndër të parat në Kosovë e fitoi betejën për realizimin e një pjese të drejtave të punëtorëve nga Kontrata Kolektive e vitit 2015 ndaj Drejtorisë së Arsimit dhe Komunës në Gjykatën e Suharekës. Ishte proces i gjatë duke i ndjekur të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për çka meritojnë një falënderim punëtorët e parë që e filluan procedurat gjyqësore dhe besuan në udhëzimet e udhëheqësisë së SBASHK-ut në nivel lokal dhe qendror. Sigurisht se atyre iu kushtoi me shpenzime më të larta por etapat që i kaluan ata ishin shembull për pasuesit në këtë proces.

Kështu tani më kompensimi i punëtorëve të arsimit që dalin në pension, si proces, mbështetet nga ana e DKA-së në Suharekë, të cilët në bazë të Kontratës Kolektive me SBASHK, marrin shpërblimin e merituar me nga 3 paga përcjellëse dhe shpërblimin e pagave jubilarë.

## **Arsimimi sot:**

### **Çka i sugjeroni SBASHK-ut që të fokusohet më shumë në angazhimet e veta?**

#### **Murati :**

SBASHK në aktivitetin e deritashëm ka bërë bukur shumë për forcimin e pozitës materiale të anëtarësisë së saj. Por a duhet të jemi të kënaqur dhe a ka ende për të bërë? Natyrisht se po!

Ne përmes dialogut të mirëfilltë me organet komunale të Suharekës, tani më kemi hasur në mirëkuptim, ashtu që për obligimet që dalin nga Kontrata Kolektive

realizohen në mënyrën më të mirë të mundshme. Komuna e Suharekës duke filluar që nga buxheti i 2018 ka krijuar një vijë buxhetore për pagesat e 13 pagave përcjellëse për punëtorët që kanë dalë në pension dhe një jubilarë për punëtorët arsimor që pensionohen. Tani më për çdo punëtor i arsimit që pensionohet, Drejtoria Komunale e Arsimit i inicion procedurat për kompensimin material të merituar sipas Kontratës Kolektive. Me këtë, mësimdhënësi që del në pension kursehet nga lodhja dhe shpenzimet e panevojshme.

Sa i përket pagesës së shpenzimeve të udhëtimit, të mbështetura edhe në Kontratën Kolektive, pas kërkesave të vazhdueshme të bëra vite më parë, Komuna e Suharekës për vitin shkollor 2018-19, gjithashtu ka filluar me pagesat e shpenzimeve të udhëtimit me 70% të vlerës së biletës së udhëtimit. Si proces, ka edhe vështirësi por besojmë se kjo do të mund të rregullohet, falë mirëkuptimit me organet komunale.

Ne, edhe në vazhdim, nën udhëheqjen e SBASHK-ut do të jemi insistues në realizimin e të gjitha të drejtave të garantuara me Ligjin e Punës, Kontratën e Përgjithshme Sindikale dhe të Kontratës Kolektive, ashtu që mësimdhënësi të ndjehet i respektuar dhe i vlerësuar nga shoqëria e në këmbim të japë si gjithnjë edhe më tepër se sa pritet prej tij.

Kërkoi nga SBASHK dhe kryetari që të bartin shqetësimet e anëtarësisë sonë sa i përket Ligjit të pagave. Konsideroi se koeficienti për punëtorët e arsimit është denigrues dhe poshtëruës. Mësimdhënësit janë të vendosur në kërkesat e tyre për rritjen e koeficientit konform përgatitjes profesionale duke i vlerësuar misionin e shenjtë të tyre.

## **Arsimimi sot:**

**Çka ju sugjeroni mësimdhënësve që nuk janë aktiv sa duhet në SBASHK?**

## **Murati:**

Aktiviteti i organizimit sindikal në çdo vend të botës bëhet, është i vetmi organizim që interesohet dhe mbron të drejtat e punëtorëve. Prandaj iu bëj thirrje të gjithë anëtarëve sindikal që në mënyrë sa më aktive të mbrojnë interesat e tyre sepse përmes kësaj njëherësh

ndikojnë në qeverisje më të mirë të qeverisjeve lokale. Përveç mbështetjes që e ceka më lartë për përfitimet e shpërblimeve me rastin e daljes në pension, ata mund të përfitojnë edhe në marrëveshjet që SBASHK-u ka bërë gjithandej në Kosovë. Përmes angazhimit sindikal do të jenë përfitues të drejtpërdrejtë në bartjen e zërit të tyre para institucioneve qeveritare.

Përfitimet janë të shumëfishta kur është fjala edhe për përcjelljen e trajnimeve si dhe me rastin e ekskursioneve dhe pushime në bregdet e në banja të ndryshme e të cilat organizohen në mënyrë të rregullt me mjete sindikale. Pra vlera simbolike e cila paguhet për anëtarësim iu kthehet shumëfish më tepër.

## **Arsimimi sot:**

**A keni diçka për të shtuar?**

## **Murati:**

Dua ta shpreh një shqetësim të mësimdhënësve janë të indinjuar dhe ndjehen të mashtruar kur është fjala për mos pagesën përkatësisht ndërprerjen e pagesës për përvojës së punës, vlera prej 0.5% për çdo vit përvojë pune, vlerë e cila tani e disa vite nuk azhurnohet në listat e pagave. Kjo çështje as që do të duhet as të bisedohet në tavolinë diskutimi por thjesht të azhurnohen listat e pagave.

Duhet të jetë më këmbëngulëse në realizimin e të drejtës të punëtorëve sidomos për realizimin e të drejtës së sigurimit shëndetësor, sigurimit pensional dhe për pensionimin e parakohshëm të mësimdhënësve me probleme serioze shëndetësore.

Sindikata të jetë më aktive dhe prezentë dhe me të drejtë fjale në komisionet për pranimin e punëtorëve arsimor dhe zgjedhjen e organeve udhëheqësetë institucioneve edukative e arsimore. Konsideroi se duhet t'i vijë fundi sistemit të çoroditur të punësimit me ndikime politike, familjare e shoqërore.

SBASHK-un kam dëshirë ta shoh kështu të mirëorganizuar, kredibil, të mirëstrukturuar dhe punët t'i planifikojë mirë. Pra, duke i dëshiruar punë të mbarë dhe suksese unë e dua SBASHK-un edhe më mirë se sa është aktualisht, ndërkaq personelin arsimor e përgëzoi për punën dhe misionin e shenjtë që ka në edukimin dhe arsimimin e brezave të reja të Republikës së Kosovës.

## Gjatë muajit

### SBASHK takim me Ministrin Shyqiri Bytyqi

Në përpyetje të përbashkëta për përmirësimin e Ligjit të pagave



Qe nga muaji maj përfaqësuesit e SBASHK-ut nuk kanë ndalur përpyekjet dhe aktivitetet për të arritur me dialog përmirësimin e Projektligjit të pagave, të cilin me arsye e kanë konsideruar si degradues e nënçmues për tërë sistemin arsimor të Kosovës. Në kudër të këtyre angazhimeve ishte edhe takimi me Ministrin e MASHT, Shyqiri Bytyqi.

Temë kyçe e këtij takimi ishte angazhimi i përbashkët i SBASHK-ut e MASHT-it për korrigjimin e projektligjit për pagat, versioni aktual i të cilit me argumente është kundërshtuar nga të dy palët dhe prandaj edhe janë pajtuar që të formojnë një komision të përbashkët i cili do të mbronte me argumente

versionin e përbashkët për korrigjimin e Projektligjit për pagat, veprim ky që do ta vendoste në vend meritore sistemin e arsimit. Përfaqësuesit dhe SBASHK-ut dhe Ministri Bytyqi janë pajtuar që në këtë komision të jetë i përfshirë edhe një përfaqësues nga Kabineti i Kryeministrit Haradinaj duke u nisur nga fakti se në takimin me të parin e Qeverisë së Kosovës e në praninë e Kabinetit të tij dhe të Ministrave Jagcilar e Bytyqi, Kryeministri Haradinaj është zotuar se do t'i jep mbështetje angazhimit që koeficientet e paraparë për arsim të korrigjohen gjatë punës së Komisionit Parlamentar për Administratë me qëllim që të punësuarit në arsim të kenë vend meritore në këtë Projektligj. Kryetari i SBASHK-ut i ka deklaruar Ministrin Bytyqi se janë duke u bërë gjithë përpyekjet që kjo çështje të rregullohet në mënyrë meritore e përmes angazhimeve e dialogut mes palëve, por nëse e gjithë kjo nuk jep rezultate të duhura, atëherë SBASHK-u do respektoj zërin e punëtorëve të arsimit dhe do të veproj ashtu kërkojnë ata. Në këtë takim është biseduar edhe për aktualitetin në arsim dhe për nevojën e angazhimeve të përbashkëta në përpyekjet për arsim më të mirë dhe për realizimin e kërkesave të drejta të punëtorëve arsimor.

### Takim i rregullt i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut

Bashkëbisedë për gjendjen në arsim dhe miratim i Buxhetit për vitin 2019



Duke respektuar Statutin e SBASHK dhe me qëllim që të bashkëbisedohet për gjendjen në arsim dhe të merren vendimet e duhura për të gjitha çështjet është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut.

Bashkëbisedë për gjendjen në arsim dhe miratim i Buxhetit për vitin 2019

Duke respektuar Statutin e SBASHK dhe me qëllim që të bashkëbisedohet për gjendjen në arsim dhe të merren vendimet e duhura për të gjitha çështjet është

mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Drejtues të SBASHK-ut.

Në hapje të këtij takimi kryetari i SBASHK-ut ka përshëndetur të pranishmit duke i falënderuar për pjesëmarrje dhe pastaj ka shpalosur shumë nga angazhimet e aktivitetet e zhvilluara nga SBASHK e në shërbim të anëtarësisë gjatë gjithë këtyre muajve të vitit 2018.



“Dy ishin çështjet madhore me të cilat SBASHK-u ishte i preokupuar dhe për të cilat ka zhvilluar aktivitete të shumta dhe madje edhe ka organizuar veprime sindikale” ka thënë Jasharaj për të kujtuar takimet me Kryeministrin Haradinaj e me Ministrin Jagcilar e Bytyqi dhe me shumë deputetë e Komisione Parlamentare gjithnjë në përpjekje që të gjenden mundësi për të rregulluar përfundimisht çështjen e Projektligjit për statusin e punëtorëve të arsimit shqip të Republikës së Kosovës për vitet e 90-ta dhe për të korrigjuar Projektligjin për pagat, i cili në versionin aktual konsiderohet i papranueshëm për të punësuarit në sektorin e arsimit. Ai edhe në këtë takim u shpreh i bindur se Projektligji për vitet e 90-ta pas një rrugëtimi të gjatë më në fund po arrin drejt cakut dhe se shpejt do të dërgohet në Parlament për leximin e dytë.

Është zhvilluar një bashkëbisedë me anëtarët e Këshillit Drejtues edhe lidhur me përpjekjet dhe sfidat lidhur me përmirësimin e ligjit të pagave. Kryetari Jasharaj tha se janë bërë shumë angazhime edhe për ta korrigjuar Projektligjin e pagave dhe se pas takimit me



Kryeministrin Haradinaj dhe takimit me Ministrin Bytyqi shpreson se në paraqitje të përbashkëta në shërbim të korrigjimit të këtij projektligji kjo edhe do të bëhet në Komisionin parlamentar për Administratë se në të kundërtën SBASHK-u do të respektojë zërin e anëtarësisë dhe do të reagojë me veprime konkrete sindikale.



Në këtë takim është bashkëbiseduar dhe është analizuar edhe Projektbuxheti i SBASHK-ut për vitin 2019. Kryetari ka informuar anëtarët e Këshillit Drejtues se Kryesia e SBASHK-ut dhe ai kanë analizuar Projektbuxhetin dhe e kanë aprovuar atë. Pas kësaj menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizimin e brendshëm, Ymer Ymeri ka shpalosur projektbuxhetin duke informuar se ai është ngritur bazuar në mundësitë buxhetore dhe duke respektuar vendimet e Kongresit dhe të Planit Strategjik të SBASHK 2015-2019. Këshilli Drejtues është pajtuar që nga mjetet e buxhetit të ndahen mjete për të organizuar edhe vitin e ardhshëm aktiviteti i pushimit dhe rekreacionit për 400 anëtarë të SBASHK-ut dhe që të shtohet buxheti për organizimin e një numri të konsiderueshëm të trajnimeve për anëtarët e SBASHK-ut. Projektbuxheti i SBASHK-ut

për vitin 2019 është aprovuar nga anëtarët e Këshillit Drejtues të SBASHK-ut.

Po ashtu në këtë takim u bë një analizë edhe e organizimit të një numri të madh trajnimesh me mësimdhënës nga disa komuna të Kosovës dhe u tha se kërkesat për trajnime të tilla do të shtohen dhe duhet shtuar edhe mobilizimin që këto aktivitete të mbahen në nivel të lartë e në shërbim të anëtarësisë. Anëtarët Këshillit Drejtues ngritën çështjen se do shtuar sasia e mjeteve nga buxheti për këto aktivitete. Për rrjedhën e trajnimeve të mbajtura deri tani

## Në një ceremoni festive në Viti

SBASHK-u pajisi me certifikata vijuesit e trajnimeve



Pasi ishte kryer me sukses trajnimi "Forcimi i Kapaciteteve për Udhëheqjen Efektive të Dialogut Social", në një ceremoni festive SBASHK-u ka pajisur me certifikata 120 për anëtarët e saj për kryerjen me sukses të këtij trajnimi.

Ky solemnitet është mbajtur në ambientet Shkollës fillore të mesme të ulët "Halil Alidema" në Pozharan të Vitisë, dhe me këtë rast janë ndarë certifikatat për mësimdhënës të komunës së Vitisë, të cilët kanë ndjekur një trajnim të organizuar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit dhe Shkencës të Kosovës, trajnim ky që është organizuar nga fundi i muajit Tetor dhe fillimi i muajit Nëntor, të cilin trajnim që ka zgjatur 32 orë, e kanë ndjekur 120 mësimdhënës të shkollave fillore të fshatrave Sllatinë e Epërme, Sllatinë e Ulët, Ramjan, Tërpezë Zhiti, Radivojc dhe nikoqiri shkolla fillore në Pozharan, ku edhe janë mbajtur trajnimet.

Në ceremoninë e ndarjes së certifikatave mori pjesë edhe kryetari i komunës së Vitisë Sokol Haliti së bashku me kryetarin e SBASHK-ut Rrahman Jasharaj,

Këshillin Drejtues e ka informuar menaxheri për financa e administratë dhe koordinator për organizimin e brendshëm, Ymer Ymeri, i cili ka thënë se trajnimet janë duke u organizuar me kërkesën e anëtarësisë nëpër komuna dhe se ato po mbahen me sukses. Ai ka përmendur se deri tani në ceremoni solemne janë shpërndarë 1182 certifikata si dëshmi e kryerjes me sukses të trajnimeve të licencuara nga MASHT dhe se këto trajnime, veç tjerash, kolegëve tanë do ju ndihmojnë në plotësimin e orëve të kërkuara për përtërije të licencave.

Drejtoresha e Drejtorisë Komunale për Arsim znj. Fatbardha Emini dhe kryetari i Sindikatës komunale të arsimit fillor dhe të mesëm të komunës së Vitisë Kemajl Bislimi.



Në fjalën e rastit kryetari Haliti, pasi ka uruar arsimtarët e certifikuar ka thënë se ky certifikim dhe licencim i juaj që ka të bëjë për forcimin e kapaciteteve tuaja për udhëheqjen efektive të dialogut social është edhe një hap i rëndësishëm avancues për ju për edukimin e gjeneratave të reja në aspektin e socializmit të tyre dhe me këtë rast falënderoj SBASHK-un dhe Kryetarin Jasharaj për punën që po bëjnë duke qenë pran anëtarësisë së vetë, por edhe duke kontribuar në ngritjen e cilësisë në arsim, për çka edhe SBASHK-u në Qendër por edhe Sindikata Komunale e Vitisë do ta ketë përherë përkrahjen e Komunës dhe përkrahjen time si Kryetar.

Kryetari i SBASHK-ut Rrahman Jasharaj i përshëndeti të pranishmit iu uroj për sukseset e treguara në trajnimin si dhe i falënderoj për angazhimet e treguara gjatë trajnimit dhe për pjesëmarrjen çdo ditë dhe çdo



kohë pa paraqit asnjë mungesë, gjithashtu falënderoj edhe Kryetarin e komunës tuaj z.Haliti dhe drejtoreshën e Arsimit znj.Emini të cilët gjatë gjithë kohës sa kanë zgjatur trajnimet i kanë vizituar pjesëmarrësit dhe kanë treguar mbështetjen e tyre për punëtorët arsimor të komunës së Vitisë. Edhe Fatbardha Emini, drejtoreshë e Arsimit të komunës së Vitisë ka uruar mësimdhënësit për trajnim dhe aftësim në këtë lëmi. E certifikatën e parë në këtë solemnitet e ka nda kryetari Haliti.

Ndryshe me trajnime të tilla në këtë komunë janë

## SBASHK dha alarmin e fundit para grevës së përgjithshme

Grevë njëorëshe në të gjitha institucionet e arsimit

përfshirë rreth 400 mësimdhënëës të kësaj komune e ky trajnim është organizuar nga SBASHK-u dhe Sindikata e Arsimit e Komunës së Vitisë.



Duke parë se janë përshpejtuar procedurat me qëllim që Projektligji i pagave, aq shumë i kundërshtuar nga SBASHK, të shkojë në komisione dhe të futet në pakon e njëjtë për votim bashkë me Projektligjin e pagave, SBASHK në një konferencë për medie ka shpallur se po fillohet me veprime sindikale. "Si kryetar i SBASHK shpall grevën njëorëshe për nesër ditë e enjte, greva njëorëshe në çerdhe do të jetë nga ora 7-8, në gjitha shkollat e Kosovës ora e parë do të jetë grevë për të gjitha ndërrimet, kurse në Universitetin e Kosovës greva do mbahet nga ora 8-9", tha Jasharaj.



Kryetari Jasharaj tha se nesër do mbahet grevë njëorëshe por nëse nuk përmirësohet situata atëherë më 14 janar 2019 paralajmëroi grevë të përgjithshme. Kryetari i SBASHK-ut para medieve u është drejtuar të punësuarve në të gjitha institucionet arsimore , që nga çerdhet e deri në Universitete.

"Të nderuar mësimdhënëës, punëtorë të arsimit, anëtarë të SBASHK-ut, të nderuar nxënës dhe prindër më lejoni që t'ju drejtohem përmes medieve duke ndjerë keqardhje pse jemi të detyruar të nisim me veprime sindikale. Ju e dini se që nga muaji maj i këtij viti kemi kundërshtuar Projektligjin e pagave , i cili është degradues e nënçmues për tërë sektin e arsimit, kulturës e shkencës. Në përpjekje për ta korrigjuar këtë projektligj kemi dërguar mjaft shkresa në adresat e Kryeministrit Haradinaj dhe të Ministrave dhe me ta kemi mbajtur edhe takime të shumta duke marrë premtime se Projektligji do të korrigjohet me qëllim që të punësuarit në tërë sistemin arsimor të kenë vend meritore në këtë Ligj. Por, edhe për kundër kësaj ky përmirësim nuk ka ndodhur deri sot, e aq më keq kohëve të fundit janë shtuar zërat në institucione që në procedurë të përshpejtuar ky Projektligj të shkojë në komisionet gjegjëse parlamentare dhe të futet në të njëjtën pako për votim bashkë me Ligjin e buxhetit. Kjo ka bërë që punëtorët e arsimit të jenë të indinjuar", ka thënë Jasharaj. Ai pastaj ka kërkuar mirëkuptim nga nxënësit dhe mbështetje nga prindërit.

"Të dashur nxënës kërkojmë mirëkuptimin tuaj dhe mbështetjen e prindërve tuaj për mësuesit tuaj. Ju kujtojmë se SBASHK-u në përpjekje për të realizuar kërkesën për përmirësimin e Ligjit të pagave e me qëllim që të mos pengohet procesi mësimor kemi organizuar një protestë në shtator, ditë e shtunë, me

kryetarët e sindikatave të shkollave dhe njërive akademike, por ky veprim sindikal e as takimet dhe takimet me udhëheqës të lartë të institucioneve të Kosovës nuk dhanë rezultate dhe prandaj unë si kryetar i SBASHK-ut shpall grevën njëorëshe për nesër ditë e enjte. Greva njëorëshe në çerdhe do të jetë nga ora 7 deri në orën 8, në të gjitha shkollat e Kosovës grevë ora e parë e të gjitha nderimeve, kurse në Universitetet e Kosovës greva do të mbahet nga ora 8 deri në orën 9”, ka thënë kryetari i SBASHK-ut duke shtuar se nëse edhe pas këtij veprimi sindikal institucionet nuk mbajnë premtimin dhe nuk e përmirësojnë Ligjin e pagave me qëllim që të

punësuarit në arsim të kenë vend meritator në të, atëherë më 14 janar 2019 do të fillojë greva e përgjithshme e në kohë të pacaktuar në çerdhe, në të gjitha shkollat e Kosovës dhe në Universitetet e Kosovës e përgjegjës për këtë do ta kenë institucionet Kosovës, të cilat edhe për kundër gjithë këtyre përpjekjeve të SBASHK-ut dhe pas premtimeve të tyre për angazhim konkret që projektligji për pagat të përmirësohet kjo deri sot nuk ka ndodhur.

Pas kësaj kryetari i SBASHK-ut duke u bazuar në autorizimet nga Statuti dhe pas konsultimit me kryetarët e ka leshur vendim për grevën njëorëshe.

## Edhe një dëshmi e unitetit të fortë sindikal në SBASHK

Në grevën njëorëshe të se enjtes 99 % e institucioneve arsimore



Për të përcjellë rrjedhën e grevën janë formuar Këshillat greviste nëpër shkolla e njësi akademike, Këshillat Greviste në nivel Komunash e të Universitetit dhe Këshilli Qendror Grevist. Ata kanë përcjellë me kujdes rrjedhën e grevës. Raportet tregojnë se greva njëorëshe është mbajtur në

99 % të institucioneve arsimore duke filluar nga çerdhet , shkollat dhe njësitë akademike, gjegjësisht Universitetet.



SBASHK-u uron që këtë alarm të fundit ta kuptojnë institucionet e Kosovës dhe ta korrigjojnë ligjin e

pagave për t'i dhënë kështu vend meritator në këtë ligj tërë sektorit të arsimit. Nëse kjo nuk ndodh atëherë i tërë sistemi arsimor më 14 janar 2019 do të jetë në grevë të përgjithshme.

Vlen të përmendet se kryetari i SBASHK-ut ka vizituar gjatë grevës Shkollën e Gjelbër në Prishtinë në ndërrimin e paradites dhe Shkollën “Ibrahim Rugova” në Kastriot ( Obiliq) në ndërrimin e pasdites. Gjatë grevës anëtarë të tjerë të Këshillit Qendror Grevist kanë komunikuar vazhdimisht me Këshillat Komunal Grevist dhe atë të Universiteteve.



Po ashtu edhe kryetarët e Kuvendeve të SAF e SAM të komunave të Kosovës dhe ai i Universiteteve, në cilësinë tani edhe të kryetarëve të Këshillave Greviste kanë vizituar shumë institucione arsimore në komunat e tyre dhe njësi akademike duke parë nga afër rrjedhën e grevës njëorëshe e duke bashkëbiseduar me grevistët , të cilët kanë qenë kategorik që nëse edhe pas këtij veprimi sindikal institucionet nuk reflektojnë dhe nuk bëhet përmirësimi i ligjit të pagave në mënyrë

që gjithë të punësuarit në sektorin e arsimit të kenë vend meritore në këtë ligj, atëherë të shkohet më 14 janar 2019 në grevë të përgjithshme. SBASHK-u edhe kësaj radhe shpreh respekt ndaj

medieve që kanë përcjellë me vëmendje këtë veprim sindikal duke i dhënë hapësirë të madhe në medie dhe duke informuar opinionin me kohë e në mënyrë korrekte për ecurinë e grevës.

## Me qëllim të informimit sa më të mirë të anëtarësisë SBASHK boton dhe publikon gazetën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK 2018”



Edhe në vitin 2018 SBASHK-u i ka dhënë rëndësi të veçantë komunikimit me anëtarësinë duke zhvilluar takime me ta. Po ashtu edhe në hapje të trajnimeve e në pauza përfaqësues të SBASHK-ut bashkë me kryetarin Rrahman Jasharaj e menaxherin për financa e administratë dhe koordinator për organizim të brendshëm, Ymer Ymeri, u janë përgjigjur shumë pyetjeve të pjesëmarrësve.

Në përpjekjet që anëtarët e SBASHK-ut të jenë të informuar saktë e me kohë për të gjitha zhvillimet dhe aktivitetet e sfidat SBASHK-u i ka kushtuar kujdes pasimit të informatave në web faqe dhe në rrjetin social. Në këtë angazhim SBASHK-u falënderon mediet e shkruara e elektronike me të cilat edhe këtë vit kishte bashkëpunim korrekt. Mediet vazhdimisht kanë gjetur kohë dhe hapësirë për të përcjellë e për të publikuar angazhimet e shumta të SBASHK-ut dhe kjo ka bërë që informacionet për ngjarjet të shkojnë

me kohë kudo nëpër Kosovë te anëtarësia jonë, por edhe të publiku në tërësi.

Me qëllim që anëtarët tonë të kenë mundësinë që të rikujtojnë e t'i lexojnë në të njëjtin vend angazhimet dhe momentet e veçanta të rrugëtimin të SBASHK-ut nëpër ditët, javët dhe muajt e këtij viti sindikata jonë boton dhe publikon gazetën vjetore “Rrugëtimi i SBASHK-ut 2018”.

Ata që punuan në këtë gazetë janë të vetëdijshëm se mund të ndodhë ndonjë lëshim i vogël teknik e gjuhësor, por e dimë se do të hasim në mirëkuptimin tuaj.

Duke ju dëshiruar lexim të këndshëm të gazetës suaj anëtarë të nderuar të SBASHK-ut ju përshëndesim dhe urojmë që viti 2019 për të gjithë ne dhe për Kosovën tonë të dashur të jetë vit i arritjeve e sukseseve.

Gëzuar.